


85H-7

TH 43



ROZI THEOHARI

# Telashe nga

## EMANCIPIMI

— Vargje humoristike —

891.983-7

TH43

ROZI THEOHARI

S

TELASHE NGA EMANCIPIMI

20720.

— Vargje humoristike —

*ROZI THEOHARI*

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: ÇLIRIM CEKA

Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stash : 2204-65

---

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1969

Stabilimenti 8 Nëndori


## TELASHE NGA EMANCIPIMI

Kur u shkund burokracia  
Pata disa «halle» t'mia,  
Por tani emancipimi  
Më sëmuri nga tërbimi.

Isha zoti i shtëpisë  
Dhe më bindeshin të gjithë,  
Se më thon' Muço Vangjeli,  
S'këndon pula, këndon gjeli.

Punën pisk e pata unë  
Gruaja kur shkoi në punë,  
Shtëpisë iu prish terezia  
Filluan dhe hallet e mia.

Kur këthehet nga uzina  
I sjell gazetën duzinë,  
Të lexojë u mësua,  
«Politika s'është' për grua!»



Dhe një ditë si pa t'keq  
Kshtu i thash e m'u përgjegj:  
— Mos kërkon të jem n'errsirë  
Që të më sundosh më mirë?

«Kur ti flet, masha kërcet  
Moj nusja ime».  
Të këndoj se si m'u tek  
Këtë këng' të gjyshes sime:

Po kërcet masha, moj gjyshe,  
Veç ksaj radhe qenka ndryshe,  
Gruas sot i erdhi zgjimi,  
Dora vetë, emancipimi.

## MANUSHAQE, NA KËNAQE!

Fshatin un s'e njifja fare.  
Që e vogël si manare  
Pranë nënës kam qëndruar  
Në qytet veç kam jetuar.

Por një her' e pata fatin  
Që ta njifja mirë fshatin.  
Atje shkova vullnetare,  
U kalita pun' e madhe.

.....  
Valixhe, çanta ngarkuar  
Ecja duke ëndërruar,  
Se pushimet si asnjëherë  
do i kaloja këtë verë.

Porse vreshti dashka shata  
Jo veç fjalë dhe urata

Se në fshat pa vajtur mirë,  
Më dhan' grurë për të shirë,

T'nesërmen që në mëngjez  
Brigadierja shum' serbes,  
Më dhuroi një derr lopatë  
Dhe u nisa me gjith' gratë.

Ja, pa prit' e pa kujtuar  
Në kanal u gjeç rrëzuar  
Më pengoi fund' i ngushtë  
Kur dola me të në fushë.

Lyer me baltë më panë;  
Fshatarët qeshën dhe thanë:  
«Manushaqe na kënaqe!  
Duam punë, s'duam shfaqje.»



## JA SI DALIN BESTYTNITË

U ngrit Safua duke qarë  
Nga një ëndërr që kish parë  
Sikur baba kishte vdekur!  
Obobo, ç'e paskësh gjetur!

Sypalarë, flokëprishur,  
Rendi te komshija ngjitur:  
— Lefkë, motër, ver xhezvenë  
Shpejt, të lutem, bëj kafënë. . .

Rëndë-rëndë qëndron Lefka  
Pupu buzët ç'po i mbledhka!  
— Korbë vajzë, ç'thot' filxhani,  
Keq e paska usta Jani!

Hasmi ju ka zën' shtëpinë,  
Okso ftoqja, okso ftoqja!  
Veç besoni perëndinë,  
Kryq' i bardh' ju qoftë ndihmë!



Iku Safua e tmerruar;  
Mbeti Lefka e gëzuar,  
Lojti falli që pa gdhirë:  
Një dhjetlekësh të bën mirë.

Veç nuk vdiq, jo, usta Jani  
(ashtu si e tha filxhani)  
Ja si dalin bestytnitë:  
U sëmur Lefka at'di'

## NA RROFTË KRUSHQIA

Nikua me Persefonin  
Njëri-tjetërin e donin,  
Por na hyjn' Vasiliqitë  
Dhe na i prishin krushqitë.

Të dy krushkat kan' një emër,  
Por ta themi ashiqare  
Kët' fejes' s'e kan' me zemër,  
Ndaj dhe s'jan' takuar fare!

Veç një ditë papandehur  
Vjen Vasiliqia ngrehur  
Dhe, ashtu, me marifet,  
Ja hedh krushkës me lezet:

— Vajzën time lozanjare  
S'kam ndër mend ta bëj fshatare.  
Ndaj duhet djalit t'i thoni  
Të heq' dorë nga Persefoni.

— Ti fort mirë na je kujtuar,  
Po dhe unë, veç, jam menduar,  
Vajzat i ke pa masë,  
Jot bijë ty do të ngjasë.

Ndaj krushka Vasiliqi  
Hiqmu shpejt nga kjo shtëpi,  
Se vajza si Persefoni  
I gjej djalit sa të doni.

Porse Nikua doli burrë,  
S'u besoi fjalëve kurrë;  
Dhe pa ardhur dit' e dielë  
E pruri nusen në derë.

Pa pajë e asnjë stoli:  
Të rroft'nusja, Vasiliqi! . .  
Pra, u lodh më kot krushqia,  
Ish m'e fortë dashuria.

## NË NJË SOFËR ME GJITH' GRATË

Në katundin Zavarakë  
Një familje na jeton,  
Nus' e vjehërr u bën ortakë  
Që të shkelin një zakon.

Për të ngrënë bukë bashkë  
në një vend burrat e gratë,  
Nus' e Cenit nguli këmbë!  
Burrat luajtën nga mentë!

Plaku shkuli fort mustaqen;  
«Nusja jon' na nxiu faqen,  
po e mori vesh katundi  
nderi shpisë vate, humbi. . .»

Nus' e vjehërr u bën' ortakë  
Bashk' me to të gjitha gratë,  
Pra, burrat u detyruan  
grat' në sofër i pranuan.

## MARIGOJA DELIKATE

Tetua me Marigonë  
biseduan deri vonë  
por të dyja nuk u bindën,  
aqë sa për pak u grindën.

Njëra thosh: — Jam qytetare  
edhe kazmën s'e njoh fare,  
prandaj bëhem fort nevrrike  
kur dëgjoj për punë fizike! .  
Ndaj dhe vajzën e ndalova,  
të mos shkojë e këshillova,  
por ma preu me të shpejtë:  
«Do të bëj, — tha, — si di vetë!»  
Dhe në letrën që më shkroi,  
flamëmadhja e pohoi  
q'është bërë si fshatare. . .  
E mban kazmën pun' e madhe. . .



Foli, foli Marigoja,  
çfarë s'vulli e s'i tha goja...  
Teto Katua e dëgjonte  
Dhe në buzë murmuronte:  
«Moj këmisha mënë-mënë,  
do vish sikundër ke qënë!...»<sup>1)</sup>

---

1) Shprehje popullore



## MARIFETI I SELMANIT

Selua, që pa gdhirë,  
Kafenë me të pirë,  
Gomarin vë përpara  
Dhe sulet nëpër ara.

Misri i kooperativës  
Ësht' rritur mashallah!  
Selua futet tinës,  
I thot' hajvanit: «Ha!

Ha, o veshëgjatë, ha,  
Se e ke badiava!»

Dhe natën, n'errësirë,  
Vazhdon ky marifet;  
Gomari ngopet mirë,  
Po Selua ka siklet:



20720

~~50624~~

«De, o veshëgjatë, de!  
Do të pëlcaç, more!»

Misri i kooperativës  
Le t'hahet, s'ka zarar...  
Mjafton ta ketë mirë  
Shëndetin një gomar!...

## DASMË ME SHEQERKA

Te premtën në drekëherë  
Na u duk Spirua në derë,  
Tha: «Të djelë na urdhroni,  
Se martohet Ksenofoni. . .»

Po, moj motër, edhe shkuam  
Të djelën që uruam;  
Gjasme shkuam në dasmë,  
Me sheqerka u qerasmë. . .

Po ç'na gjet' ne të shkretët  
Që nuk hëngrëm dot as drekë:  
«Do të hamë, — thamë, — në dasëm,  
Aqë shumë sa do pëlçasëm!»

Atje s'hëngrëm dot, as pimë,  
Veç kënduam me rininë,  
Dasm' i thënçin, mashalla!  
Pa jahni, pa bakllava. . .

Dasma po, bënim njëherë,  
Çdo i ftuar sillte shqerrë,  
Tundej fshati dhe shtëpia  
Nga gostia, nga rakia.

Tani them me veten time:  
Ç'jan kto dasma pa shpenzime?  
Dasma po s'harxhoi pare,  
Më mirë të mos bëhet fare...»

Kështu fliste Marigoja,  
Volli, e çfar s'i nxori goja!  
Dhe as që nuk e pandeu  
Kur e mbesa e ndërpreu:

«Po, moj teto Marigo  
ne nuk ecim n'vend numro,  
ndaj dhe dasm' e Ksenofonit  
nuk u bë sipas zakonit.

Se zakoni që ti thua,  
Rakia të derdhet krua,  
S'është më, i doli boja»  
S'foli më dhe Marigoja.

## E KAM BURRIN PËR QOSHE

Të bëjë burri punë për mua?  
Ç'janë këto, moj, që më thua!  
Le pastaj ta dijë dhe halla,  
Do të zjejë gjith' mëhalla,

Siç po zjen tani për Tazen,  
Që i vë burrit përparsen;  
Pa dhe djalin n'kopsht ia shpie.  
Pika Tazes që s'i bie!

Nus' e Nasit «me kimet»,  
Domosdo, kur e ka gjet'  
Atë Nas, një palo burrë,  
Që dhe tavat çon në furrë.

Apo ç'mbahet dhe Havaja!  
«Isha, — thotë, — nga kinemaja»  
Në shtëpi lë burrëzinë  
Të kujdeset për fëminë...

Burrë po, burrë kam unë,  
Që s'e vë në asnjë punë,  
Rri i ndrruar, kallëp misri,  
Si zotni dhe burrë fisi. . .

## ARSIMTARI NË FSHAT

Fshati yn' gëzoi një ditë,  
njerzit rendnin nga shtëpitë  
kush të delte më i pari:  
se na erdhi arsimtari.

Ish një goxha arsimtar,  
Varur n'qafë një kollar  
në kollar na ish qëndisur  
një majmun i argalisur.

Dukej në mes të katundit  
veshur pas modës së fundit:  
gjoksi fryrë, kamardare,  
pantallonat t'ngushta fare.

— S'dashka fshati kallauz, —  
tha Xha Hysa me namuz —  
se me kto që po shoh unë,  
besa, kena me msue shumë! . .





Fjala e xha Hysës doli,  
katundarve se ç'u polli. . .  
T'hapej shkolla erdh' orari,  
por s'po dukej arsimtari.

Dielli hipur tre hostenë,  
arsimtari n'fshat po kthen:  
ishte miku në qytet,  
bulevardi atje e pret . . .

## NUSJA, QË MË DHA NËNOJA...

Nusja, që më dha nënoja  
Ka tridhjet çarçaf me hoja,  
Ka dhe tre jorgan atlasi  
Dhjetë mbulesa plastmasi. . .

Lumi unë, O

Nuses, që më dha nënoja  
Nat' e dit' s'i pushon goja,  
Pajën, duke numëruar,  
Gratë na i ka hutuar!

Lumi unë, O

Po gëzohet farefisi,  
Se i veshi kallëp misri,  
Nusja që më dha nënoja,  
Ndaj dhe s'e lëshojn' nga goja,

Lumi unë, O

Pa ç'ka, se thonë disa  
Trut' i paska fukara!  
Na mjaftojnë trut' e mia,  
Boll të jet' e pasur shpia

Lumi unë, O, lumi unë, O...

## U RROFTË KULTURA

«Nëna ime s'ka kulturë  
Ndaj në shpi nuk e mbaj kurrë»  
Thosh i madhi, Lym doktori  
Ditën që diplomën mori.

Nënë dboi edhe Ferhati  
Se në shpi iu prish rehati.  
Pa dhomë pritje djali mbeti,  
Atje flinte nënë Serveti.

Edhe nusja e djalit tretë  
E dëboi vjehrrën vetë.  
«S'shkohet me këtë injorante!»  
Dit' për dit' nënë e shante.

«I kam rritur me thërrime  
Për ta shojta jetën time,  
Tash u rroft' «nivelsiteti»  
Psherëtin nënë Serveti...»


## NË AKSION ME SHOQET SHKOI

U vërtit në shtrat Naumi,  
Tërë natën s'e zu' gjumi,  
Vajza do të shkoj' n' aksion,  
Diç në zemër e sëmbon.

E mendoj punën gjatë,  
E zgjoi gruan që me natë,  
«Shpejt, — i tha, — ik' te Vanthia,  
Të fillojë mblesëria!»

Evanthia me një frymë  
Ngjiti shkallët me shum' bujë,  
I ra derës, zgjoi Vefin,  
Ndërsa n'zemër kish peshqeshin.

«Njoh një vajzë, zonja Vefi,  
Daç për shkollë, daç vajz' gjergjefi;  
Apo pajën dhe stolinë:  
Të ta veshë gjith' shtëpinë,



Apo s'i ka dhe njerëzinë!  
Se njeriu kur merr zogun  
Do të mirë dhe kuvlinë. . .

Përfundoi mblesëria,  
U gëzua dhe Vanthia,

Se Naumi ia shpërblevi,  
Këpucët e reja ia blevi.

Por mbaroi shpejt kjo lojë,  
Mbet' Naumi me gisht n'gojë:  
Vajza mblesërinë s'pranoi,  
Në aksion me shoqet shkoi.




## E KAM DJALIN DELIKAT

Thirri Kristua: «Moj Frosinë!  
ç'na e prishnë terezinë,  
Berti, djali jonë  
N'punë fizike shkon.»

Frosina bëri kryq  
dhe u plas mbi një sëndyq  
«Ç'po më thua, more burrë?  
Berti s'ka punuar kurrë!

Djalin tonë avokat  
E nderon qytet e fshat,  
Ta dërgosh në balt' e shi?  
Larg qoftë një plemoni.

Un' e zeza djali jonë  
Si do bëjë të punojë?,  
A po s'është delikat!  
Ndaj e bëmë avokat.



E zeza si do bëjë  
Për të ngrënë, medet!  
E ka mësuar nëna

Të hajë për tre vet.  
Djal' i nënës për të fjetur  
Do ta ket' të but' dyshekun?»

Mbahu Berti burrë,  
S'të lodh puna kurrë.


## LAMJA HA... MISH DERRI!..

Lames, fanatik me okë,  
Na i hypte gjaku n'kokë,  
Kur i flisje për mish derri,  
Menjëher' fillonte sherri:

«Mor jahu, pse s'këlldisi?  
Derr nuk mbajmë, dhe bitisi.  
Gjysh stërgjyshësh trashëguar,  
Derri na është ndaluar.

Dhe ata të kryesisë,  
Që s'i binden perëndisë,  
Le ta rrisin derrin vetë,  
Nëpër lluca kan' me mbetë...»

S'shkoi shumë dhe Lamën tonë,  
Në një dasmë na e ftojnë,  
E na therin goxha derr!  
Që t'u bëjnë miqve nder.



«Vallahi kësisoj mishi  
S'e ka ngrënë as dervishi»...  
Thriste Lamja i mahnitur,  
Thelat duke i mbllaçitur.

Por nga mentë sa s'shajtoi,  
«Hëngrëm derrin» kur dëgjoi.

## TANË MOJ, SHOQJA BERBERE!...

Ç't'u hap nami anembanë  
Tanë moj, e lumja Tanë,  
Se zanat të ri fitove,  
Fshatin fort na e gëzove.

Tanë moj, e lumja Tanë,  
Që na qethe burrat tanë.  
Tanë moj, shoqja berbere  
Keq e paske kësaj here...

Se xha Pilua me mustaqe  
Fort na qenka skuq' në faqe:  
«Ku është' parë — tha — një grua  
Të më qethë kokën mua!...»

Po ngado që shkon e vete  
Merr të ndryshme epitete:  
«Tungjatjeta, o uratë...»  
Na e përshëndesin gratë.

Tanë moj, shoqja berbere,  
Thashethemet shpejt i preve,  
Se një dit' xha Pilon panë  
Që u fut në berberanë!...

## KUR SËMURET GRUAJA

«E ke gruan të sëmure  
Balli po i digjet furrë!»  
S'po më lë rehat mileti  
Si të dal prej ktij sikleti?

«Çoje — thonë — te doktori  
Se të keqen kjo ta mori.»  
«Mor jahu, pse sekëlldisi?  
Nuk e çoj — u them — bitisi.»

Nuk e gjen gjë jo, për besë  
Ja njoh trupin un' Ervesë,  
Ësht e fortë si një kalë,  
Prit sëmundja kur t'i dalë.

Ësht e fortë s'ke ç'i thua  
Katër shpirtra ka kjo grua,  
Sa sëmundje ka kaluar,  
Trupi vetë ja ka shëruar...



Më në fund u bind qyqari,  
Dhe s'pushonte dot së qari,  
Kur doktori i tha «von,  
Po t'a them. . . zor se shpëton. . .»

## TERRENI YNË... «SPORTIV»

Më në fund mbaroi terreni,  
U gëzua fort dhe Leni.  
Veç në ankth, nga padurimi,  
Pret t'mbaroj inagurimi...  
Dhe, pa gdhirë dita tjetër  
Me vrapimin njëqind metër,  
U sul Leni tok me gratë,  
Rrjetën kush më shpejt ta kapë.  
Kshtu, nga rrjetë volejboli  
«Tel për rroba» se ç'na doli.  
Ja dhe gropa «kërcim së gjati»  
Jetën të shkurtër ç'e pati:  
Gjyshet nga janë e nga s'janë,  
Vijnë fërkojnë kazanë,  
Apo dushet, ç'mrekulli!  
Na u bën' lavanderi... »

Dhe vazhdojnë prap kërkime,  
Nuk ka ditë pa ndryshime.  
Pra, tani, një emër gjeni  
Se si vete më «terreni... »

## KJO ËSHTË RRUGA MË E RE

Hall me vjerrë e hall pa vjerrë,  
Zu të qahej Lenë e mjerë,  
Po të kthehesh von' nga puna,  
Menjëher' fillon furtuna:

«Leno, bëhu nikoqire,  
Se në shpi s'je mysafire,  
Pa t'i rrish në këmb' qiri,  
Djalit, që e kam flori.

Eh. . . nuse ishim një herë,  
Që nderonim vjerr e vjerrë,  
Binim, ngriheshim me hënë  
S'kishim kohë për të ngrënë! . . .»

Kshtu vazhdon vjerra të flasë,  
Shan e shan Lenon pa masë,  
Ndërsa Lenua mendohet,  
Me ktë vjerrë më nuk shkohet.

Leno, kokën mos e ul  
Vazhdo punën më me ngulm,  
Bind dhe vjerrën, po më nge  
Kjo është rruga më e re...

50621

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Telashe nga emancipimi .....	3
Manushage na kënaqe .....	6
Ja si dalin bestytënitë .....	8
Na rroftë krushqia .....	10
Në një sofër me gjith' gratë .....	12
Marigoja delikate .....	13
Marifeti i Selmanit .....	16
Dasmë me sheqerka .....	19
E kam burrin për qoshe .....	21
Arsimtari në fshat .....	22
Nusja që më dha nënoja .....	26
U rroftë kultura .....	28
Në aksion me shoqet shkoi .....	29
E kam djalin delikat .....	32
Lamja ha mish delerri .....	35
Tanë moj, shoqja dhe berbere. ....	37
Kur sëmuret grua .....	39
Terreni ynë «sporniv» .....	41
Kjo është rruga e re. ....	42